

UNIVERSITETI SHTETËROR I TIRANËS
INSTITUTI I FOLKLORIT



*POSI ZJARRI
E SI SHKËNDIA*

(KËNGË POPULLORE PËR RININË)

TIRANË, 1971

Sektori i folklorit gojor

Tirazhi 4000 kopje

Formati 78x109/32

Stash 2204-65

Shtypur në N.I.SH. të Shtypshkronjave «MIHAL DURI»

PARATHËNIE

Në këngën e madhe të popullit tonë ka hyrë **edhe** rinia shqiptare; ka hyrë me buzëqeshjen e saj të **gjerë**, me zemrën trime dhe të pastërt, me vrullin, èndrrat dhe dëshirat e saj rimore. Populli, duke i kënduar **rinisë** me frysëzim e dashuri, shpreh dhe krenarinë e tij për këtë rini, besimin e tij të madh në të. Ky qëndrim i **popullit** ndaj **rinisë** së vet e ka bazën te fakti se të **rinxjtë** e të rejat shqiptare, gjatë rrugës së tyre të lavdishme, me punën, luftën dhe jetën e tyre, kanë treguar se janë **bij** e bija të denja të një populli trim, patriot, punëtor e liridashës. Dhe kënga popullore është një dëshmi e **gjallë** dhe origjinale e asaj së vërtete që shoku Enver e ka shprehur në mënyrë të qartë e sintetike: «*Ruga e rinasë* është me të vërtetë një faqe e lavdishme e historisë së popullit tonë».

E rëndë dhe plotë vuajtje ishte jeta e **rinisë**, si ajo e mbarë popullit tonë, në të **kaluarën**. Mbi të rëndonte edhe zgjedha e huaj, edhe zgjedha e klasave shfrytëzuese, edhe kanunet e egra mesjetare, edhe nizami apo kurbeti; por rinia shqiptare nuk desh të pajtohej dhe nuk u pajtua me një gjendje të tillë. Kënga popullore tregon se rinia u vu në radhët e para të luftëtarëve të lirisë kombëtare; ajo u ngrit kundër shtypësve të brendshëm dhe luftoi me të gjitha forcat për drejtësi e jetë më të mirë; përdori të gjitha mjetet e mundshme në kushtet e së kaluarës dhe shumë herë shkelmoi me guxim normat dhe kanunet mesjetare, që po i ndrydhnin vullnetin dhe i thanin èndrrat e dëshirat legjitime. Dhe mendimi i shëndoshë popullor ka qenë gjithmonë me anën e **rinisë**.

Tiparet më të mira tradicionale të **rinisë** sonë u ngritën në një shkallë më të lartë, u pasuruan dhe u mbrujtën me një ideologji të re, me ideologjinë e

Partisë sonë, gjatë Luftës nacional-çlirimtare, që u udhë-hoq nga Partia dhe shoku Enver. Kënga popullore, përmjet faktesh të shumta, përgjithësimësh të gjera artistike e shembujsh të lartë, tregon se, siç ka thënë shoku Enver, «Rinia është bërë flamurtarja e luftës së sotme. Ajo është e para që e tundi zgjedhën e okupatorit... Asaj kurrë nuk i është trëmbur syri dhe kudo është hedhur me zell dhe vetmohim të pashqoq».

Kur atdheu ynë dolli nga lufta (vërtetë i zhuritur e me plagë të shumta, por fitimtar e i lirë) dhe hyri në periudhën e rindërtimit e të ndërtimit socialist, rinia jonë, pa lënë mënjanë pushkën, rrëmbeu kazmën dhe u vu në radhët e para të ndërtonjësve të socializmit, u bë «pararojë në çdo punë», siç thotë kënga popullore. Populli me këngën e vet i thur lavde punës heroike të rinisë së tij, çmon lart kontributin e saj në ndërtimin e socializmit në vendin tonë dhe në mbrojtjen e fitoreve të arritura, tregon se, siç ka thënë shoku Enver, «s'ka ndryshim, s'ka përparim, s'ka realizim në vendin tonë që të mos ketë markën e rinisë, që të mos jetë shkrirë në të dituria, guximi, sakrifica, patriotizmi i shkëlqyer i rinisë sonë».

Dashuria e flaktë e rinisë sonë për popullin e atdheun, për Partinë dhe shokun Enver, vrulli i saj revolucionar, guximi dhe heroizmi i saj, pjekuria politike dhe urrejtja e thellë kundër çdo gjëje të vjetër dhe të mykur shkëlqyen me një drithë të veçantë gjatë luftës për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës në të gjithë vendin tonë. Ajo, e edukuar dhe e kalitur në kudhrën e Partisë, u hodh me guxim e para në çdo aksion politik, ideologjik, ekonomik a shoqëror dhe «në themel i vu qysqinë» çdo gjëje që do të pengonte ecjen tonë përpara.

Në këtë vëllim, ku botohen disa nga krijimet më të mira poetike të popullit tonë për rininë, lexuesi do të gjejë shembuj të shkëlqyer të forcës dhe guximit, të dashurisë për atdheun, lirinë dhe punën, të zgjuarësisë dhe shkathtësisë, të vullnetit dhe ndershëmërisë së rinisë shqiptare që në kohët e hershme e gjer në ditët tona.

I

KĒNGĒ LEGJENDARE

GJERGJ ELEZ ALIA

Trim mbi trima ai Gjergj Elez Alia! (1)
 Qe, nandë vjet nandë varra (2) në shtat m'i ka!
 Veç nji motër, natë e ditë te kryet,
 ja lan varrat me ujët e gurrës nandë vjeçë,
 5 ja ter (3) gjakun me ata flokët e ballit...
 Ka dalë zani e paska marrun dhenë
 se nji baloz (4) i zi ka dalë prej detit,
 ja kish qitun dheut nji rreng të randë:
 Tym për tym (5) nga nji dash të pjekun,
 10 tym për tym nga nji vashë me ja djergun, (6)
 ditë me ditë nga nji kreshnik me premun,
 javë për javë nga nji krahinë me djegun!
 — Amanet, more vëlla, mos me m'pasë randë,
 për nji dert që sot po due me t'qa:
 15 Qysh s'u njom ky shtat, qe, nandë prenvera?
 Si s'u mkamb ky trup me dalë te dera?
 Si s'u tha kjo motër, thafta vera?

1) Gjergj Elez Alia, trim i ri, është një hero pozitiv i epikës sonë heroike popullore. Ai ka veti morale të larta, përfaqëson krenarinë, guximin dhe heroizmin tradicional të popullit tonë. Duke vënë mbi të gjitha lirinë, ngrihet nga shtrati, ku lëngonte nëndë vjet nga nëndë plagë të rënda dhe vret balozin.

2) plagë

3) Ja than, ja fshin.

4) Balozi përfaqëson në këngë pushtuesin e huaj, që kërkon të nënshtrojë vendin e ta detyrojë të paguajë taksa të rënda.

5) shtëpi për shtëpi

6) T'i çojnë, t'i dërgojnë.

Po unë balozit qysh i shkoj te dera?... (1)
 Ça kish ba ai trimi Gjergj Alia?
 Falë me shndet balozit m'i ka çue:
 «Me dalë heret n'atë fushën e mejdanit! (2)
 Çikë pér ty, baloz, nuk m'ka qillue; (3)
 desht e vathit pér ty nuk m'janë majmë;
 sall (4) nji motër, nuk mund me e lëshue,
 25 varrët e shtatit s'ka kush me m'i lidhë!»
 Sa ka nisë drita me zbardhë majet,
 n'fushë t'mejdanit trimat paskan dalë;
 keq me fjälë shoshojnë po e rrekin; (5)
 — A prej vorrit, Gjergj, ti qenke çue?
 30 Pse me m'qitë, bre burrë, n'këtë fushë mejdanit? —
 Sa mirë trimi i ka përgjegjë balozit:
 — Të lumët goja, baloz, mirë po thue!
 Qe, nandë vjet që kam marrë rrugn e varrit,
 pak pa mbrritë, baloz, ti m'ke dredhue.
 35 M'ke lypë motrën, para se mejdanin;
 m'ke lypë berret, para se çobanin;
 e jam dredhë m'këtë log pér me t'kallxue,
 se ne t'parët nji kanun na kanë lanë:
 Armët me dhanë pérpara e mandej gjanë!
 40 Kurrë balozit motrën mos me ja dhanë,
 pér pa u pre n'atë fushën e mejdanit! (6)
 Por shtërnghohu, baloz, se t'ka ardhë dita,
 se ktu i thonë Gjergj Elez Alia! —
 E i kanë ba dy gjogat (7) tym me tym

- 1) Motra e Gjergji Elez Alisë sintetizon karakteristikat tipi-
 ke të vajzës shqiptare: ndershmërinë, thjeshtësinë, besnikëri-
 në, dhe dashurinë e pakufishme pér vëllanë, guximin, etj.
 2) Fushën e luftës, të dyluftimit.
 3) S'më ndodhet, s'kam vajzë pér ty.
 4) vetëm.
 5) Po e mundojnë, po e shpojnë.
 6) Përgjigja e Gjergjit është një kuadër i gjallë i shpirtit
 luftarak dhe i luftës heroike që ka bërë populli i ynë gjatë she-
 kujve kundër nënshtrimit, shtypjes, tiranisë.
 7) kuajt e shalës.

45 e n'topuz (1) balozi e ka shënue;
n'dy gjutë gjogu Gjergjit te i ka ra,
përmbi krye topuzi i ka fjurue, (2)
dymbdhjetë pashë m'ledinë u ngul topuzi,
dymbdhjetë pashë përpjetë si re asht çue pluhni.
50 Atëhere Gjergjit rendi (3) te i ka ardhë;
sa mirë trimi n'topuz që ka dredhë:
Lik (4) përmjet balozit te i ka ra;
asht trandë fusha kur asht rrzue balozi!
Me njihërë trimi shpatën ma ka nxjerrun,
55 kryet me neje trupit ja ka damun,
zhag për kambet trupin e ka ngrehun,
me gjithë at m'nji bunar e ka mbytun;
të tanë lumin gjaku e ka tërzue,
për tri vjet krejt vendin e ka qelbun!...

1) Shkop i trashë druri me kokë të madhe dhe si të rrumbullakët, që dikur përdorej si armë lufte, për të goditur kundërshtarin.

2) Ka fluturuar.

3) radha

4) pikërisht, tamam.

II

KENGĒ HISTORIKE TRADICIONALE

RINA E RADHAVANI

Humbi Rina tē vällanë,
tē vällanë, Radhavanë;
ma kérkoi ajo tri ditë.
Tri ditë eci něpér diell,
5 tri net eci něpér hënë,
e gjeti ně fund tē vrarë.
E vu mbi një mushk'të zezë
dhe u kthye drejt e prapë.
Duke shkuar ně një pěrrua,
10 u ul tē çlodhet dhe e mbuloi
djalin me flamur tē vet.
Shkoi ordhia e Arminoit:
— Ném' një pikë ujë, o Rinë!
— Un' nuk kam me se tē t'jap.
15 — Jepma ně grusht tēnd, o Rinë.
— O ti qen e tradhëtar,
ti mos fol kështu me mua,
se, ně zgjofsha tim välla,
do t'ju bëjë copë-copë!
20 — T'qofsha falë, mos, o Rinë.
sa tē shkojmë këtë mal,
këtë mal dhe malin tjetër! (1)

1) Vajza fyhet nga Arminoi, tē cilin kënga na e jep si një renegat, që i shërbën sulltanit. Përgjegja krenare e saj e tmeron kundërshtarin, i cili, kur ndien emrin e Radhavanit, ua mbath këmbëve nga një mal ně tjetrin.

Pasi ikën, zonja Rinë
zu e qau mbi të vëllanë:
— Radhavan, vëllau im,
kur tani këta të trëmben,
ç'bënin kur ti ishe gjallë! (1)

25

1) Radhavani, Pjetër Shini, Pal Golemi, Nik Peta dhe sa e sa të tjerë, që përjetësohen në këngët e bukura arbëreshe (të shqiptarëve të Italisë), formojnë vargun e luftëtarëve popullorë, që ranë në betejat e popullit tonë kundër vërshimit turk.

ME SE ERDHE, KU I KE SHOKËT

Shtatë shalnjanë (1) kanë ra në Shtojt (2),
 i kanë dhanë besën shoqishojt;
 shoqishojt i kanë dhanë besën:
 «Në saraj do t'bjemë e t'vdesim,
 5 nuk po e ndrrojmë sodin (3) për nesër!»
 Na i mbuloi flaka, i mbuloi tymi!
 A thue shpëtoi kurrnjani gjallë?
 Sall (4) i shkreti Marash Palë,
 dymbdhjetë pushkë seç e kanë marrë.
 10 Deli Pjetra, kraht' e bardhë,
 fluturim ka ra në Shalë.
 Po i thotë lokja: — Pse ke ardhë?
 Me se (5) erdhe, ku i ke shokët?
 — He, për ty i prefsha flokët! (6)
 20 — Nuk kam ardhë, nanë, me shpëtue,
 po kam ardhë me ju kallzue,
 se e kem'ba nji nam në Shkodër. —
 Deli Pjetra fort idhnue,
 drejt në Shkodër ka dredhue,
 25 tre vetë vdekun i ka lëshue!

1) Shtatë krerë të Shalës, të cilët i kish thirrur në Shkodër Ibrahim Pashë Bushati, rreth vitit 1816, për t'i detyruar që t'i shtroheshin sundimit të tij dhe i preu në besë.

2) Fushë në verilindje të Shkodrës.

3) të sotmen

4) vetëm

5) përsë

6) He, mos të paça, për këtë turp që bëre (nëna kujtoi se ai kish lënë shokët dhe kish ardhë në fshat të shpëtojë kokën).

KURVELESH KRYE TË NGRINI

Kurvelesh, krye të ngrini,
 gra e burra armë vini,
 nizam' Turqis' mos i ipni! (1)
 Ç'u ngren', o shokë, ç'u ngrenë
 5 Kuç, Kallarat e Bolenë,
 treqint niviciot' levendë (2),
 gjashtëdhjet' golëmë (3) qenë,
 Progonat derë më derë,
 Lekëdush ata që qenë,
 10 të gjithë e bënë benë:
 — Djemtë tanë nizam' s'venë!

1) Qeveria turke deshi të zbatojë në vendin tonë, ashtu si edhe në krahinat e tjera të perandorisë, ligjet e reja të tanzi-matit, që qenë shpallur më 1839; por populli ynë, kudo, i kundër-shtoi me armë këto ligje. Në fillim të qershorit të vitit 1847 fshatarët e Kurveleshit përzunë një kryengritje, që kishin ardhur në Kuç për të mbledhur taksa e nizamë, në bazë të këtyre ligjeve, dhe fillojnë një kryengritje, që njihet si një nga kryengritjet më të përgjakshme të fshatarësisë sonë për liri.

2) trima

3) Prej Golemi, fshat i Labërisë.

ME PALLA LËFTONI SHESHIT

Në Stamboll kartra dërgojnë,
se raea (1) po lëftojnë,
që në Berat e në Vlorë!
U mbush deti me pamporrë.
5 Një pasha me tre taborrë
misërishtatë i korrë;
s'e dinë me kë lëftcjnë!
Me Gjolekë Kuçin, (2) thojnë.
Gjolek' e Hodo Aliu (3)
10 në dorë palla ç'u ngriu;
Tafil Buz (3) mustaqeziu
nga Gryk' e Kuçit arriu.
More djem të Kurveleshit,
me palla lëftoni sheshit!
15 Kurveleshi, gur i thatë,
me palla lëftojnë gratë.
O halldup shallvaregjërë,
në të zënça dot guberë, (4)
do ta bëj si tjetër herë!

1) Këtu: të shtypurit.

2) Zenel Gjoleka nga Kuçi, udhëheqësi kryesor i kryengritjes kundër tanzimatit më 1847.

3) Udhëheqës të tjerë të kryengritjes.

4) Një lloj pelerine që vinte gjer mbi gju.

3234

50500017

DO TA MBUSH RRAPIN TË VRARE

Proto marsi, (1) në të hyrë,
 asqer nga Janina vijnë;
 në Mashkullorë, (2) në brinjë,
 rrethosën fshat'e xhaminë...
 5 Në mëngjes e ndaj të gdhirë,
 zunë borit'e po bijnë,
 panë komitat që dilnë.
 Zabiti vuri dylbinë,
 njohu Zenon e Çerçizë.
 10 Mu tek Rrapi, (3) më të dalë,
 hodhë bataren' e parë,
 e goditnë Hadrullanë. (4)
 Dhe Çerçizi tha dy fjalë:
 — Vërtet Hajredin'e vranë,
 por hakën s'ja le pa marrë;
 në mazapë (5) e në xhandarë,
 do ta mbush Rrapin të vrarë!
 Lule Çerçiz Topulli,
 vulose për Shqipëri!

1) Në fillim të marsit.

2) Fshat i Gjirokastrës, ku, më 5 mars 1908, luftoi kundër ushtrisë turke çeta e kryengritësve shqiptarë, që kryesohej nga Çerçiz Topulli.

3) Rrapi i Mëshkullores.

4) I riu Hajredin Tremishti, pjesëmarrës i çetës së Çerçiz Topullit.

5) ushtar i rregullt

NDESH PËR BURRA N'DO DJEM TË RI

Hajmedet, po ban mileti,
 duel kanuja e erth hyrrjeti, (1)
 hypi m'post Sulltan Mehmeti;
 hypi m'post nji sultani i ri,
 5 e çoi asqerin në Shqipni,
 me gri burra e me gri fëmi. (2)
 N'Kaçanik kur desht me hy,
 Kaçanikut raft-u pika,
 nuk e lshoi pa u therë me thika;
 10 u ther me thika shtatë sahat,
 u mbyt kali m'not në gjak!
 Kaçaniku ca ka thanë:
 «Robt' të gjallë nuk muj me i dhanë,
 për me vdekë po i qes të tanë! (3)

1) «Kushtetuta» që shpallën turqit e rinj më 1908 e që, në mënyrë demagogjike, premtonte të drejta. Populli ynë e kuptoi dredhinë dhe u ngrit më këmbë.

2) Me gjithë masat e egra që mori Xhevít Pasha më 1909, populli ynë nuk u përkul. Në pranverë të vitit 1910 fshatarësia e Kosovës kapi përsëri armët kundër sundimit turk. Qeveria turke atëhere dërgoi një nga gjeneralët e saj më të zotë, Shefqet Turgut Pashën, në krye të 70.000 ushtarëve, për një operacion të ri në Shqipëri, për mbledhjen e armëve, të taksave dhe për zbatimin e shërbimit ushtarak të detyrueshëm.

3) Shefqet Turgut Pasha u prit me plumbë kokës. Në shkallë të Kaçanikut u zhvillua një betejë e përgjakshme (11-13 maj 1910). Armiku la më se 600 të vrarë.

15 Kur u shkoq Pasha prej Gashit,
ndesh pér burra n'kodér t'Palçit; (1)
ndesh pér burra, n'do djem tē ri,
asht nisë pushka njiqind e një mi (jë),
fushë e mal po duken zi.
20 «Kanë hy n'shkam, nuk mund t'i ndal;
po qes m'pushkë, po hallakatin;
po qes top, gjylen ma kapin!» (2)
Durgut Pasha hyp në sukë, (3)
paska mbetë pa ujë, pa bukë,
25 pa xhephane, pa barut,
asht kthye mrapa, ka ra n'Pukë.

1) Në Mertur; këtu u bë një tjetër përleshje e përgjakshme midis shqiptarëve dhe turqëve. Turgut Pasha, prej kësaj qëndrese, u detyrua tē heqë dorë nga kalimi nëpër malësi dhe të bjerë në Shkodér duke shkuar nëpër Pukë.

2) Janë fjalë tē Sh. Turgut Pashës.

3) kodér

BJE' HALLDUPIT TË PABESE

Bedri Pasha (1) çon haberin:
 — Ksaj Malsisë me i marrë asqerin;
 njizetvjeçat (2) me i gatue,
 se n'Jemen po du me i que!
 5 — Njizetvjeçat e Malsisë,
 muernë malet e Shqipnisë...
 Kush n'sakicë (3) e kush me kmesë, (4)
 bje' halldupit të pabesë!
 Tanë Malsia asht betue
 10 pa gjak malet mos me i lëshue;
 kta pesë male kanë ba be
 me derdhë gjakun për atdhe:
 «Do t'luftojmë na për Shqipni,
 me na u njoftë shqipja resmi!» (5)

1) Komandant turk, që u dërgua për të shtypur kryengritjen e 1910-ës.

2) Njëzetvjeçarët, djemtë e rinj.

3) sépatë e vogël.

4) Vegël me të cilën presin drizat, ferrat etj.

5) Kjo këngë flet për ngjarjet që ndodhën në vendin tonë
 në pragun e shpalljes së pavarsisë. Lufta e popullit shqiptar në
 këtë kohë kishte hyrë në fazën e saj të fundit; shqiptari lufton
 me vendosmëri, me një ideal të qartë dhe me një perspektivë të
 afërt për çlirimin e atdheut nga zgjedha shekullore turke.

Resmi = me veshje zyrtare, zyrtarisht.

MIRO TËRBAÇJA

E zeza Miro Tërbaçe, (1)
 moj e rritura bonjake, (2)
 nëpër dyer të Tërbaçe,
 ike te berberi vajte:

5 — O berber, o sha vëllanë, (3)
 do ma lësh çepen' (4) si djalë,
 se do vë dyfek e pallë,
 do marr hakë pér babanë,
 pér baban' e pér vëllanë!

1) Vajzë nga Tërbaçi. Sipas të thënave të popullit, bejlerët e Vlorës i kishin vrarë të jatin dhe të vëllanë. Miroja del në qytet, vishet si djalë dhe merr hak pér babanë e vëllanë e saj.

2) jetime

3) Shprehje përbetuese a përgjëruese, si: «pér kokën e vëllait», «qafsha vëllanë» etj.
 4) ballukan

HAXHI GASHI NJI TRIM ME FLETË

Haxhi Gashi (1), nji trim me fletë,
 kap mauzerren e del nebet; (2)
 kap mauzerren, nebet ka shkue,
 Allamani i asht afrue:

- 5 — Pse s'ma pret nderimin mue?...
 M'kamxhik djalit i ka mshue.
 Haxhi trimi, pa u vonue,
 me mauzerre ja ka dredhue;
 me mauzerren mirë ja ngjiti,
 10 s'vonoj shumë e i duel shpirti;
 i duel shpirti, hajmedet,
 mbet Haxhia pa fishekë!
 Pa fishekë nuk ka çka ban,
 merr mauzerren teslim e ban.
- 15 Të xhumanë, në dy sahati,
 burizani fort vikati:
 — Tri taborre me i ba gati,
 sot do vritet Haxhi Gashi! —
 Haxhi Gashi, nji djalë i ri,
 20 i kanë lidhë sytë me shami.
 — Mos m'i lidhni sytë e mi,
 se nuk jam i anadoll-li,
 po jam shqiptar kosovali! (3)

1) I ri nga Kosova; vrael një oficer se e ofendoi duke i rënë
 me kamzhlik. Akti i tij është një revoltë kundër brutalitetit të
 oficerëve të atëhershëm dhe tregon krenarinë e shqiptarit, i cili
 nuk e duron poshtërimin.

2) roje

3) Le të vihet re krenaria me të cilën shkon drejt vdekjes
 ky djalë i ri.

TTANË ZAPТИTË QESH TUE I LA N'GJAK

Osman Taga, nji djalë prej Ferri (1)
 n'at pazar ç'e zeka sherri;
 ç'e zu sherri me do zapti, (2)
 me la paret në meri: (3)
 5 — Me la paret pa derman!
 — T'parn e shpisë këtu s'e kam,
 Haxhinë të qes dorzanë.
 — Ku di unë ku rri Haxhia?
 — Dredhou kndej, t'kallzon alltia!... (4)
 10 M'i thuej nanës, mos qaj për mue,
 t'qajë martinën, (5) që s'm'ka qëllue;
 t'më ndodhei martina njat, (6)
 t'tanë zaptitë qesh tue i la n'gjak!

- 1) Katund i Krujës (sot në rrëthin administrativ të Tiranës).
- 2) xhandarë
- 3) bashki
- 4) koburja
- 5) lloj pushke
- 6) afër, pranë, më vete

HALIL GASHI NJI DJALË I RI

- Halil Gashi (1), nji djalë i ri,
 N'Fushë Gjitet (2) ka deshtë me hi.
 Beqir Agës i ka thanë: — Zotni,
 as ma jep nji tokë çifçi? (3)
- 5 — Në ma dhansh motrën Hajri,
 hin e zgjidh në shtatdhjetë shpi!
 — S'ta kam vaktin për mik me ty!
 — Nuk ta lyp për miqësi,
 veç se ka dy syt' e zi...
- 10 Gjashtë herë m'pushkë, pesë herë m'allti:
 — Për hajër të qoftë motra Hajri,
 rrotulloje e merre n'gji!

1) Fshatar i ri nga rrëthi i Prishtinës. I kërkoi një copë tokë Beqir Agës për të punuar si bujk. Ky tallet me Halilin, bile e prek në nderin e familjes. Atëherë Halili i jep përgjigjen e merituar.

2) Fushë pranë Prishtinës, ku kishte pronat e veta Beqir Aga.

3) Ai që punonte tokën e feudalit dhe merrte vetëm një pjesë të mundit të vet.

LUFTË PO BAN NJI DJALË I RI

N'Beshiktash (1) po këndon fermani, (2)
 n'atë Stamboll po bahej nami:
 Luftë po ban një djalë i ri,
 na u mbush rruga n'suvari... (3)

5 Myrto Ftiani (4) i kish thanë:
 — Smail Beg, hakun me ma dhanë;
 Smajl Beg, hakun sot ta dua,
 robtë pa bukë më kanë qëllua!
 Me kërbaç më je kërcnua,

10 m'ke sha robtë e m'ke sha mua.
 M'u dridh toka për nën kambë,
 kur m'i shave babë e nanë! —
 Hoq alltijen, ja ka dhanë:
 — Moj alltija, qofsh bekua,

15 që ma zbardhe faqen mua! —
 Çoi e thirri Hasan Pasha:
 — Ti ksaj pushke, djalë, me i ra hasha. (5)
 — Hasha, pashë, nuk dua me i ra;
 me i ngranë hakun fukarasë!

20 N'pastë mbetë gjallë, prapë dua me e vra!

1) Lagje e Stambollit.

2) Urdhër i sulltanit.

3) kalorës

4) Nga Kraja e Shkodrës; vrau zotërinë e vet në Stamboll, se nuk deshi t'i paguajë hakun (rogën) dhe se e qortoi me fjalë të rënda duke e prekur në ndër.

5) Ta mohosh, të pendohesh.

KURRË S'PO SHKELET KJO SHQIPNI

- C'asht kjo luftë në Malzi? (1)
 — Lufton Italja me daji; (2)
 na i ka djegë disa shtëpi.
 Njaj Tahiri, djalë i ri, (3)
 5 n'kullë me Lajen (4) tek ka hi,
 e rrethoi Italja me sufari...
 Kur ka ardhë askeri n'derë,
 top e pushkë u ba jezerë, (5)
 pesë xhenaze përnjiherë.
- 10 — Pesë xhenaze, t'tanë 'taljanë,
 bashkë me Lajen i kemi bamë! —
 N'gjithë Evropën shkoi haberi:
 Lah Rexhepja, nji vajzë pér seri, (6)
 i muer manxerren nji askeri;

1) Krahinë e Lumës (në perëndim të Kukësit).

2) trim

3) Tahir Rexhepi nga katundi Petkaj (Shumri-Kukës). Italia-nët e ndiqnin dhe domin ta zinin. Më 1919 e rrethuan në kullën e vet, por ai luftoi trimërisht.

4) E motra e Tahirit, e cila i rrëmbeu pushkën nga duart një ushtari dhe luftoi bashkë me të vëllanë kundër forcave ushtarake italiane, që kishin ardhur të arrestojnë Tahirin.

5) mjegull, tym

6) Një vajzë e çuditshme.

- 15 i muer manxerren me njiqind fishekë:
«Bashkë me vllanë, tha, due me vdekë!»
Kral' i Itales bën pleqni:
«Kurr s'po shkelet kjo Shqipni,
mësue n'borë, mësue në shi,
20 bukë pa ngranë e ujë pa pi;
qesin gratë me pushkë për sy,
si askeri talimxhi...» (1)

1) Si ushtarë të stërvitur.

LËFTOJNË E S'U TUNDET KËMBA

Evropa shkruajn' e thonë:
 — C'është kështu, si dëgjojmë?
 — Bënët dyfek në Vlorë,
 shqipëtarët po lëftojnë
 5 me një mbret dyzet milionë. (1)
 — Po me se lëftojnë vallë?
 — Me sëpata, me hanxharë,
 dyfeqet lidhur me gjalmë,
 fyshekët në xhep i mbajnë.
 10 Ç'paskan pjellë ato nëna,
 paskan pjell'e bërë drëra,
 lëftojn'e s'u tundet këmba!

1) Është fjala për luftën e Vlorës më 1920, kur populli ynë i hodhi në det imperialistët italianë, që mbanin të pushtuar Vlorën.

AVNI VATANË E NDEROVE

Telegrafët vin'e venë
 pyesin për Avni Rustemë: (1)
 «Vrau Esat Pash 'Zadenë!»
 O Avni Rustem Marina, (2)
 shkove burra, shkove trima,
 në Paris ç'e bëre prima, (3)
 qëllove si vetëtima!...
 Qëllimin seç e mbarove,
 Esat Pashën ç'e qëllove.
 10 U ngren' policët e thanë:
 — Kush e qëlloi pashanë?
 — Un'e vrava qerratanë,
 se punonte propagantë
 me Serbin'e me Junanë. (4)
 15 Avni, vatan'e nderove,
 Shqipërinë e gjëzove!

- 1) Hero i popullit, lindi më 1895. Gjatë tërë jetës së tij u
 shqua si patriot dhe revolucionar. Më 1920 vrau në Paris Esat
 Pashën, i cili ishte vënë në shërbim të imperialistëve dhe rre-
 zikonte pavarësinë e Shqipërisë. Avni u vra pabesish nga njerëz
 të vënë prej Zogut (12.IV.1924).
 2) Avniu ishte nga lagja «Marinë» e Libohovës.
 3) E bëre fora, si burrat.
 4) me Greqinë

RROFSHIÑ DJEMTË TANË SHKOLLARË (1)

O ju shok' e ju xhanllarë,
 mbani vesh t'u them një fjalë:
 Rrofshin djemtë tan' shkollarë,
 që shkojn' të shpëtojnë vatanë!

5 Policia pse s'i lanë,
 që të venë në Tiranë?
 «Atje kemi njerzit tanë!...»
 Sytë fare u jan' zënë!
 Për kolliuk, fron të ërgjentë,

10 tradhëtinë nuk e lënë! (2)

1) Ju këndua nga populli i Tepelenës studentëve vullnetarë të Korgës, që shkuau në ndihmë të revolucionit demokratikoborgjez të 1924-ës.

2) Populli demaskon politikën antipopullore të feudoborgjezisë së vendit.

DJAL' I POPULLIT HALIM

Të kish rritur Labëria,
 djal' i popullit Halim, (1)
 Halim Xhelio, trim o trim!
 Të kish rritur Shqipëria,
 5 të prit' të dilje në Vlorë
 me flamur të kuq në dorë;
 po ti u trete i mërguar,
 në Franc e në vënd të huaj,
 Shqipërin' për të shpëtuar.
 10 Mbahu, moj djaléri, mbahu,
 Halimi rrugën e çau,
 hall'e popullit e qau!

1) Halim Xhelua nga Tërbaçi i Vlorës; luftëtar i patundur për çlirimin e masave tonë punonjëse nga zgjedha feudoborgjese. Me ardhjen e Zogut në fuqi u detyrua të jetojë në mërgim (në Francë etj.), ku punoi si revolucionar dhe komunist. Vdiq në Moskë, në janar 1937.

III

KĒNGĒ LIRIKE TRADICIONALE

VASHËZA MANDILEVERDHË

- Vashëza mandileverdhë
shkon me furkën duke tjerrë.
— Moj mike ballësuliote,
më treti sevdaja jote!
- 5 Mos na shko përpara stanit,
se të ha qen' i çobanit!
— O çoban, çoban i dhënet,
në ke besë, bjeru qënet.
- 10 — Qëntë s'janë për të vrarë,
gushëbardha për të parë.

DOLLI SORKADHJA NGA PYLLI

Në mëngjes, posa ra ylli,
 dolli sorkadhja nga pylli,
 u thërret shoqeve: «Dili,
 dili se këndon bilbili,
 5 dolli marsi e hyri prilli,
 çeli vjollca e trëndafili!»
 — Sorkë, të keqen e syrit,
 kur del te vij' e mullirit,
 rrije pranë trëndafilit
 10 si hënëza pranë yllit!

A JE BRYMË MOJ A JE BORË

A ja brymë, moj, a je borë, moj e holla!
 e bukur vetullkunorë; >>
 e bukura kuq në faqe >>
 si hana që shkrep në bahçe; >>
 5 e bukura synë si yll, >>
 kur ma çel e kur ma mbyll, >>
 si hana që shndrit në pyll. >>

MORI DRANDOFILLJA E BARDHË

Mori drandofillja e bardhë,
kur mora gjethin me ty,
mora detin-o me sy;
në mjedis të detit-o
5 ish nji lis i vogël-o;
sa i vogël liši ishte,
sa të madhe hije kishte.
Ktu mrizojshin-o nandë grigjë,
nandë grigjë me nandë kumonë,
10 t'gjithë nji vashë po i rrotullon,
me nji thuper gem lejthi;
na i ra manarit n'sy,
pikoj lotja e ra në det,
u ngri deti akull-o,
15 mbetën barkat shakull-o! . . .

UNË TANUSHËN VETË E KAM PA (1)

..... : :
 Unë Tanushën vetë e kam pa:
 Vetulla e saj drejt si fiskaja; (2)
 shteku i ballit si shteku i malit,
 kur merr hana me prendue;
 5 syni i saj si kokrra e qershisë;
 e ka qerpikun si krahu i dallndyshës;
 ftyra e saj si kuqet molla n'degë;
 hunda e drejtë si kalemi i Tushës;
 goja e vogël si bula që shpërthen;
 10 dhambët e bardhë si gurëzit e lumit
 fill mbas shiut, kur po i shndrit dielli;
 qafa e saj si qafa e pullumbit;
 shtati i saj si shtat çetine; (3)
 misht e dorës porsi rremi i shemshirit. (4)

1) Ky fragment është marrë nga një këngë e ciklit të kreshnikëve (këngë legjendare me karakter epiko-heroik, që këndohen kryesisht në Malësinë e Veriut).

2) thupër e hollë

3) lloj pishe; borigë

4) fildish

DASHUNIA NUK HARROHET

Qan Bardhoka n'hije t'bojlisë, (1)
 tuj fshi lotët me skaj t'shamisë;
 qan e shkreta për pa da,
 nis bojlia për m'u tha,
 5 nisin fletët n'tokë me ra;
 e me vajn' po nis vajtimin,
 nemka bjeshkë e nemka vrrinin,
 trujka (2) shpin'e trujka stanic,
 nem çobanët, kur jau ndin zanin:
 10 — Ju çobanë, kurr' mos këndofshi,
 ju, moj lule, mos lulofshi;
 u rrënnofshin malet tonë,
 ujë pjetposhtë (3) mos djergtë (4) Valbona!...
 Qan Bardhoka nën bojli,
 15 veç po qan për at djalë të ri,
 u ba shumë kohë pa e pa me sy...
 «Me ja thanë dy fjalë unë due:
 — Zemra thahet e shkrumohet,
 guri thehet e coptohet
 20 druni kalbet e shkatrrohet,
 po dashnia nuk harrohet!»

- 1) qershi
- 2) mallkuaka
- 3) tatëpjetë
- 4) zbritët

ME GROSH MIXHA MË KA SHITË

— O kuku, qyqe, moj, ku je kanë, (1)
 ku je kanë, tha, ku je rritë?
 — Sa u bana për me ditë, (2)
 me grosh mixha (3) më ka shitë.
 5 Kur më erdhën për me m'marrë,
 me zor mixha m'futi (4) n'kalë...
 Mora rrugën për me shkue,
 me nji ksollë m'kanë ndalue;
 m'kanë ndalue m'kanë shkarkue,
 10 E kur mrrini (5) i lumi aksham,
 kur ma prunë dhandrrin hashan, (6)
 njizet enes (7) tirqit e gjanë,
 me shumë xhepa, me shumë gajtanë,
 njizet kutë regzinat (8) n'kambë,
 15 plot silahin me bagërdanë; (9)
 kish nji qese plot me duhan,
 kish çibukun njizet pllame.
 Ku me gjetë unë aso burri?
 I shkon tymi si tym pampurri! (10)

1) Ku ke qënë.

2) Sa fillova të kuptoj, kur isha ende shumë e re.

3) Xhaxhai, vëllai i babait.

4) Më hodhi, më vërviti.

5) Mbrriti, arriti, erdhi.

6) I egër, i vrazhdë, i trashë nga sjelljet.

7) Masë që përdoret për të matur stofin e leshtë.

8) Një si rrobë e leshtë, me të cilën mbështjellin këmbët para se të veshin opingat.

9) kaçamat.

10) Sobë, stufë. Me anën e kësaj kënge, që i përket kohës para çlirimit, populli godet zakonin e shëmtuar të shitjes me para të vajzës në moshë të njomë tek një burrë të shkuar nga mosha, pa pyetur fare për ndjenjat e vajzës.

M'KA DHANË BABA NJI BURRË TË KEQ

— Mori e mira shteg më shteg,
pse t'ka kapë gjithë ky kasavet? (1)

— M'ka dhanë baba nji burrë të keq;
burrë të keq; nji burrë fëmi,

5 ma zen gjumi me krye n'hi;
ma zen gjumi pa granë darkë,
e marr n'krah e çoj në shtrat;
po m'lyp qeni buk'e djathë,
po vjen macja me ja ngranë,

10 po më thrret: «I ziu, oj nanë!»
S'asht i zoti me e përzanë.
«S'më ke nanë, qofsh mallkue,
s'më ke nanë, po më ke grue!» (2)

1) merak, shqetësim, hidhërim

2) Mendimi i shëndoshë popullor, siç shihet edhe në këtë këngë, ka qënë gjithnjë kundër martesave të pabarabarta.

U NIS PLAKU E DJALI BASHKË

U nis plaku e djali bashkë,
 ç'e poqnë çupën në udhë.
 Djali thoshte: — Ta marr unë. —
 Plaku thosh: — Po s'ta le unë! —
 5 Çupa thotë: — S'e dua plaknë,
 se ka kurrizin të dalë.
 — Prit, çupë, të të qaj hallë:
 Vajta një ditë me dhizë,
 më zuri një vesë shi,
 10 ra shpella më zu kurrizë. —
 Çupa thotë: — S'e dua plaknë,
 se ka dhëmbëtë të rarë. (1)
 — Prit, çupë, të të qaj hallë:
 Vajta në pazar me dardhë,
 15 kisha një pelë të bardhë,
 bishtkorra ktheu samarë,
 më qëllon me këmbë të parë,
 më theu dhëmb'e dhëmballë. —
 Çupa thotë: — S'e dua plaknë,
 20 se ka mustagen të bardhë.
 — Prit, çupë, të të qaj hallë:
 Vajta një ditë në nulli,
 fryu er'e drekës,
 m'hodhi miellin mjekrës.

1) të rënë

NUK ASHT PLAKA PËR SOKOLA

U zu vasha, u zu plaka,
 u zunë pér djalë tē ri.
 Plaka thotë: — Ta marr vetë!
 Vasha thotë: — Ta marr vetë!
 5 — Ti, moj plakë, shka i jep ktij djalit?
 — I jap nji oborr me lopë,
 i jap grigjen (1) me kumbonë,
 i jap arën pa u korrë.
 — Ti, moj vashë, shka i jep ktij djalit?
 10 — i jap ballin perishan, (2)
 i jap vetullën gajtan,
 i jap synin si filxhan,
 i jap hundën miskalli, (3)
 i jap faqen gurabi,
 15 i jap gojën si kuti,
 dhambë e dhëmballë inxhi, (4)
 i jap shtatin si selvi,
 i jap qafën si zambak.
 — Hajt, moj plakë, e rri ndér pula,
 20 se je bamun rrudha-rrudha;
 hajt, moj plakë, e rri te ksolla,
 nuk asht plaka pér sokola!

1) kopenë

2) Me stoli që vinin nuset.

3) Hundën tē derdhur si pipëza.

4) perlë, margaritar

DJEM U HËNGRI KSENITIA

Kur kujtojte atë ditë, (1)
 i vetëm i nënës-o!
 M'u bënë rrëth kushërinjtë,
 dhe vëllezërit të gjithë,
 5 për ti, o djal' i florinjtë.
 O djalë, përse s'më shkrove,
 të keqtë të ma tregoje?
 Trëmbeshe mos m'hidhëroje?
 Me martinë ç'më qëllove,
 10 zëmërën seç ma thërmove!
 Djem, u hëngri ksenitia, (2)
 Amerika e Galia! (3)

1) Ditën që nënës i sollën mandatin për vdekjen e **djalit**
të vetëm në kurbet.

2) kurbeti, mërgimi
 3) Franca.

Shfrytëzimi i egër i së kaluarës, papunësia etj., i detyronte
djemtë shqiptarë të mirrin rrugën e hidhur të kurbetit. Se çfarë
 fitonin nga kjo, na e thotë vetë kënga.

QANI O NËNA NA QANI

Dal në breg e vështroj fshanë, (1)
 derë më derë po qajnë,
 u venë djemtë nizamë. (2)
 Sos (3) u venë në kurbet,
 po nizam për shtatë vjet.
 5 «Në pyeçi, nëna, për ne,
 mësojm' mushka hergjele, (4)
 ngremë gur' e ngremë dhe.
 Në fushë të Manastirit
 10 ndreqim vëndin e talimit; (5)
 vend'e talimit ndërtojmë,
 po të zeza nëna ç'thonë?
 Qani, o nëna, na qani,
 shami të zeza. të mbani,
 15 sa të vimë nga nizami!
 Qani, moj të zeza gra,
 është shtatë vjet dava!»

1) fshatin

2) Ushtarë në kohën e Turqisë.

3) semos

4) Të rritura fushave, të hazdisura.

5) Vedin e stërvitjes ushtarake.

IV

KĒNGĒ PĒR LUFTĒN NACIONALCLIRIMTARE

MERRNI ARMËT DHE I BINI

Shtatë dit' kish hyrë prilli, (1)
 u tha bari e tërfili,
 s'këndon qyqja, as bilbili,
 shkeli Shqipërin' fashizmi!

5 Bërtet Nëna: (2) «Djem, ku jini?
 Merrni armët dhe i bini!
 Në mos kini armë, gjeni,
 ja rrëmbeni atij qeni!» (3)

1) Shtatë prill 1939. Që këtej fillon epopeja e madhe e Luftës nacionalçlirimtare, që udhëhoqi Partia dhe shoku Enver.

2) Shqipëria

3) fashizmit

ME GJAK PO T'I HEQ RINIA

Flamur, të mbuloi zia!
 O flamur more,
 për flamur, more! (1)
 Qëkur erdhi Italia,
 5 të vuri spatat e tia; (2)
 me gjak po t'i heq rinia!
 Në male të Shqipërisë,
 valon flamur'i lirisë.
 O vëllezër shqipëtarë,
 10 lini këngën, lini vajnë,
 po na pret lufta e parë,
 me sëpatat, me hanxharë!

1) Vargjet 2 e 3 përsëriten.

2) Në kohën e pushtimit fashist, shqiponja e flamurit tonë u rrethua me simbolin e fashizmit — me sëpatat dhe tufat më thupra.

DJEMTË TANË PARTIZANË

Seneja tridhjet'e nëntë,
 fryn një er'e një stuhi,
 gjithë sqelat ç'u nxinë.
 zbret fashizmi Shqipëri . . .

- 5 Si në Jugë dhe Veri,
 djemtë tanë partizanë,
 t'edukuar në Parti,
 gjithë popullit i thanë:
 «Merrni armët për liri!...
 10 Pa shikoni atje sipër,
 në male, në Shqipëri,
 djem e pleq të bashkuar
 po lëftojnë për liri».

DOLLI ENVER HOXHA VETË

Dolli ylli që me natë,
 na ndriçon e na bën dritë,
 në katunde, në qytete,
 në male të Shqipërisë

- 5 dolli Enver Hoxha vetë
 me flamurin e lirisë;
 propagandës ja filloi
 udhëheqës' i Partisë,
 i bë' (1) thirrje puntorisë,
- 10 popullit edhe rinisë:
 «T'i hapim luft' Italisë,
 Italis' e Gjermanisë;
 vëndin tonë ta çlrojmë
 nga prangat e robërisë!»

1) i bëri

E TUNDE PARTI E TUNDE

Shqipëri, o yll, o dritë,
 lumthi ti a për të ritë,
 për Partinë komuniste,
 që punon nat' e ditë
 5 për një themel të çelniktë!...
 Shqipëri, baçja me lule,
 rrofsh, moj, rrofsh që s'u përule!
 E tunde, Parti, e tunde!
 Përpara si pak e zure,
 10 me ca të rralla kobure,
 ca prita, ca mina vure,
 me djemt'e vajzat si nure,
 ato që mbathën poture,
 me dyfek, me sakature,
 15 me opinga prej lëkure.

GJËMON KLITHM'E DJALËRISË

Në male të Shqipërisë
gjëmon klithm' e djalërisë,
ngrihet flamur'i lirisë.

5 — O shokë, për Shqipërinë,
sa të zhdukim skllavërinë,
dhe të fitojmë lirinë
për fshatar', për puntorinë!...

PO LËSHOHEN DJEM E VAJZA TË BASHKUAR

- Nëpër kodra, fush'e male trumbetohet,
zëri fort i çetës po dëgjohet.
Anembanë po bashkohet djalëria,
që të gjithë grumbullohen nga Partia.
- 10 Djem e vajza, gjithë ajk' e Shqipërisë,
ven'e marrin direktiva prej Partisë.
Po lëshohen djem e vajza të bashkuar
me një zemër, me një shpirt vëllazëruar,
po drejtohen tek shpëtim' i së vërtetës,
- 10 po u prinë përpara grupi i çetës;
grup'i çetës partizane komuniste,
që i fut drithmën gjithë trupave fashiste.
Duallë çetat, duallë shokët partizanë,
në katunde, në qytete, anembanë.
- 15 Shok'e shoqe bëjnë çeta luftëtare
dhe nga plumbat e fashizmit s'trëmben fare
Tok punëtorë e fshatarë bëjnë çetën,
për liri po bëjnë luftën, lënë jetën;
shok'e shoqe bëjnë luftën për lirinë:
20 — Do ta bëjmë krejt të lirë Shqipërinë!

T'U KĒNDOJMË TRIMAVE

T'u këndoymë trimave, (1)
 që flenë lëndinave,
 dyshek kanë tokën-o,
 jorgan kanë gunat-o,
 5 vëllezër fishekët-o,
 shtëpi kanë shpellat-o!
 Ata vuajnë për liri,
 se nuk duan robëri!

1) trimave partizanë

JAM NJË VAJZË SHQIPËTARE

Dua arm'e municion,
se do shkoj,
e urej dhe u fashizmin,
do lëftoj.

- 5 Jam një vajzë shqipëtare,
vajzë mali,
e kam forcën, e kam zëmrën
si të djalit.
- 10 Jam e fortë si një djalë,
do lëftoj,
njësoj pushkën edhe bombat
përdoroj.
Borën, breshërin edhe shiun
ç'i duroj;
- 15 duroj ftohtë e nxehtësirë,
duroj shumë;
duroj vojtjet e mundimet,
buk'e gjumë.
- 20 Duroj se dua lirinë
e mëmëdheut,
për flamurin kuq e zi
të Skënderbeut.

KUDO QË PO SHKON TI ÇLIRON VATANE

Njëzet e ca ditë luftë në Tiranë,
 të keqen e emrit, moj Brigad'e parë! (1)
 Lëfton Italinë bashkë me Gjermanë;
 ti futesh në top, futesh në murtajë,
 5 shkatërrrove Ballin me gjith' tradhëtarë.
 Opo ikën Balli, ikën duke qarë:
 «Burrani, o shokë, vjen Brigad'e parë,
 se ajo na vret e na zë të gjallë;
 të këtillë djema, neve s'kemi parë,
 10 të gjithë të zgjedhur, gjithë vullnetarë!»
 Neve Mehmet Shehun kemi komandant;
 Mehmet Sheu ynë ka luftuar Spanjë.
 Të keqen e emrit, moj Brigad'e parë.
 kudo që po shkon, ti çliron vatanë.

1) Përsëritet pas çdo vargu.

Brigada e parë sulmuese, nderuar me titullin e lartë «Heroi i Popullit», u formua më 15 gusht 1943 në Vithkuq të Korgës me partizanë nga të gjithë anët e Shqipërisë. Luftoi me heroizëm në Vithkuq (1943), gjatë ofensivës gjermane të dimrit 1943-44, etj. Faqet më të lavdishme të historisë së saj i shkrojti me luftimet që bëri në Mokër, Çermenikë, Pezë, Dumre, Sulovë; me shpartallimin e ofensivës gjermane të qershorit 1944, me asgjësimin e mercenarëve dhe të reaksionit në veri e sidomos me luftën he-roike për çlirimin e Tiranës (nëntor 1944).

S'KE PAR' DJEMT' E SHQIPÉRISË

Moj Mavrov'e Drashovicë, (1)
 aman ç'hoqe atë ditë!
 Partizanët me nazistë,
 bomb' më bomb'e thik' më thikë!
 5 Hysni Kapua si petrit
 në tela seç u vërvit,
 ç'u plagos e ç'u godit,
 e lidhi këmbën me rrip,
 armikut në gjuh' ç'i flit: (2)
 10 — Dorëzohu, mor jezit!
 S'ke par' djemt' e Shqipërisë,
 me opinga gomë llastik,
 me jelek e pa këmishë,
 i marrin plumbat në sisë!

1) Fshatra në rrëthin e Vlorës. Këtu në shtator të 1943 u bë një betejë e përgjakshme, e para betejë e madhe, midis forcave partizane, të udhëhequra prej sh. Hysni Kapo, dhe push-tuesve gjermanë.

2) I fliste në gjuhën e tij (të armikut).

GJAKUN MOS MA FALNI

Brenda në Tiranë,
 mu afër Spitalit,
 ç'u vra Qemal Stafa, (1)
 një trim nga të malit!

5 C'e muarën mbrapa
 spiunët e djallit,
 luftoi me patllake
 gjersa i dolli xhani.
 S'kish pushkë të gjatë,
 10 si s'pat lumëmadhi!
 Motra shqipëtare,
 zi për të të mbani.
 Nëna e tij plakë
 shkon e qan tek varri:
 15 — Ngreu, Qemal i thotë
 ç'bën te Varr'i Bamit? (2)
 Dje më erdhi karta
 nga çetat e malit...
 Ngreu, të keqen nëna,

1) Hero i popullit, militant i shquar i Partisë Komuniste Shqiptare, anëtar i KQ të PKSH, Sekretar politik i Rinisë Komuniste Shqiptare. U rrethua më 5 maj 1942 nga forca të mëdha karabinierësh e milicësh fashistë; luftoi deri në fishekun e fundit dhe ra burrërisht në fushën e nderit, duke u bërë shembull i lartë vetmohimi për mijra të tjerë që ndoqën rrugën e tij të lavdishme.

2) Varreza në Tiranë.

- 20 tē duan partizanët!
— Kam marrë tri plagë,
plumba italianî;
tē më mirret haka,
gjakun mos ma falni!
- 25 Popullit shëndenë,
qëndroj si luani;
nënë, lamtumirë! —
I thotë Qemali.

MISTO MAMES

Brënda në Tiranë re,
 Misto Mame (1), o lule!
 S'le hotel, s'le kafene,
 në kopësht, në çdo bahçe,
 5 konferenca shokëve,
 luftove për një ide.
 Rinisë ç'kujtim i le?
 — Rinis' i lashë flamurë.
 — Puntoris' ç'kujtim i le?
 10 — U lashë botën e re!

1) Hero i popullit, nga Erindi i Gjirokastrës; udhëheqës i njësiteve guerile të Tiranës dhe anëtar i KQ të RKSH; luftoi me vendosmëri për çështjen e madhe të popullit e të Partisë; ra heroikisht më 16 gusht 1942, duke luftuar kundër forcave fa-shiste.

DËSHMORËVE TË VIGUT (1)

— Ndalni, djema, ku po shkoni?
 Ka urdhnue kapidan Gjoni (2)
 nj'ato armë t'i dorzoni!

- 5 — Këto armë që kem' shtërngue,
 s'i kem' ngjeshë për me i dorzue;
 nj'at zakon nuk jem' tue e msue!
 S'jemi cùba (3) belaçi,
 jemi djemt'e ksaj Shqipni.
 Tash pesë vjet na tue luftue,
 10 mal më mal e prrue më prrue,
 pa bukë n'bark e laskarue, (4)
 veç për t'mirën e vendit tonë;
 «partizan» emnit na thonë
 edhe luftn e kem' zakon!

1) Më 21 gusht 1944 në luginën e Vigut në Mirditë 300 e ca tradhëtarë rrëthuan pesë partizanë: Ndoc Mazin, Naim Gjylbegun, Ndoc Dedën, Ahmet Haxhinë dhe Hydajet Lezhën. Trimat luftuan deri në fyshekun e fundit dhe ranë duke mbajtur lart flamurin e popullit e të Partisë.

2) Gjon Marka Gjoni, bajraktari i urryer i Mirditës.
 3) hajdutë
 4) të rreckosur

O PARTIA HEROIKE

O Partia heroike,
 të madh udhëheqës që ke,
 Enver Hoxhën syshqiponjë,
 birin trim të maleve!
 5 Shqipërin, e bëri zonjë,
 të bukur baçe lule.
 Titistët dhe hrushovjanët
 s'gjejnë shteg këtej nga ne,
 se qëndron Partia e Punës
 10 trime në mes dallgëve!

N'T'KATËR ANËT NA PYET BOTË

N't'katër anët na pyet bota:

— Vallë ku gjindet Enver Hoxha?

— N'ato male ku s'dirgjet (1) bora,
te i ka mbledhë do djem sokola;

5 djem sokola, djem të ri,

Mehmet Shehu me shokt e ti,

filloi luftën për liri;

filloi luftën anembanë,

fluturim hyni n'Tiranë;

krejt Tiranën ka çlirue,

me gjak rrugët janë mbulue!

Na u çlirue krejt Shqipnia,

na u vendos demokracia,

rroftë Enveri dhe Partia!

10

1) nuk shkrin

PUNO MOJ RINI ME FLAKE

Për ty, o rini,
dy fjalë do thom:
Ku ke qënë, moj e mjerë,
dhe ku po jeton!

5 Ti ke qënë në mjerime,
fash po lulëzon;
ti ishe që dje luftove,
sot po rindërton,
Atdheun e shkatërruar
10 po e lulëzon!
Lumtërin' thurrja Partisë,
ajo t'udhëzon...
Puno, moj rini me flakë,
asnjëherë mos përto;
15 e arthmja është e jotja,
socializmin lulëzo!

SHOQE NA THËRRET PARTIA

Shoqe, na thërret Partia
 që të jemi pararojë,
 në çdo anë të mëmëdheut
 djersën tonë të kullojmë.

5 Shoqe, vihuni në radhë
 Shqipërinë ta bëjmë dritë,
 të punojmë me forcat tona,
 të punojmë nat' e ditë!

10 Armiqtë le të pëlcasin,
 armiqt' le të vjellin vrer;
 ne na prin Partia e Punës,
 timonier shoku Enver!

TI MOJ VAJZA SHQIPËTARE

Erdhi koha dhe për ne,
 dil, moj, dil moj, vash'e re!
 Ti dolle për të lëftuar,
 dil tani për të punuar,
 5 dil tani për të kënduar.
 Ti, moj vajza shqipëtare,
 bëre një luftë të madhe;
 vashëza si moll' e kuqe,
 hodhe pushkënë në supe.
 10 O Parti, moj famëmadhe,
 kaptove gjith' ato halle,
 tani që kemi lirinë,
 do ndërtojmë Shqipërinë.

PËR PARTINË SHQIPE MALI

Shoqë, do këndoj një këngë
 për jetën e re,
 shpirt e zemër të dëfrejë,
 mbushur me hare;
 5 të buçasi kënga jonë
 si vullkan mbi dhe,
 le të mburret Shqipëria,
 të sajt jemi ne.
 Shini vëndin si stoliset
 10 porsi nus'e re,
 sa e lumtur lind pranvera
 bukur mbi Atdhe.
 Djersa çurk le të pikojë,
 iktë si rrëke,
 15 fruti i punës ësht' pérhera
 lumturi pér ne,
 pér Partinë Shqipe mali,
 pér jetën e re!

PARAROJË KJO RINI

Seneja dyzet e shtatë,
 plan'i par-o për çudi,
 çelet hekurudh'e parë,
 ore djem, në Shqipëri!
 5 Hapen rrugë dhe kanale,
 si në Jugë edhe Veri,
 në të gjithë këto punë
 pararojë kjo rini;
 ajo fjalën e Enverit,
 10 asnjëher' s'e bëri dy!

POSI ZJARRI E SI SHKËNDIA

Gjëmon shkëmbi, tundet vëndi,
 shkon rinia si ergjëndi;
 si ergjëndi shkon rinia,
 posí zjarri e si shkëndia.

5 Dilni e shihni rininë,
 nga «Rrug'e dritës» (1) po vijnë,
 Së-t e Lë-t (2) u vetëtijnë.

1) Rruga që con nga Miloti te hidrocentralet «Karl Marks» e «Frederik Engels».
 2) S e L: shkurtime të fjalëve «sulmues» dhe «lavdëruar».

N'KAMBË ASHT NGRITË GJITHË RINIA

Ç'ka Lamskoni (1) që gjimon?

Minatori po lufton!

Ai s'ban luftë ma me gjerman,
po me malin që asht shkamb.

5 Ka Ishue fjalen n'Mirditë Partia,
n'kambë asht ngritë gjithë rinia...
Në kto male gur'e shkretina,
ku bante çerdhen vec gjeraqina,
e ku vojte (2) ndonji korb i zi,

10 aty janë hapë sot galeri;
galeri me shumë puntorë,
nat'e ditë me kazëm n'dorë,
tue ra shi e tue ra borë,
shkojnë ke puna tue këndue.

15 Plaku e djali tue bisedue,
plaku djalin na e ka pyetë:
— A do t'jetë kjo punë vërtet,
në Lamskon m'u ba qytet? —

Djali plakut na i ka thanë:
— Jo n'Lamskon që asht vend me nam.
por n'Shqipni ne asnji pllame
pa punue nuk do ta lamë
e kudo qytet me e bamë. —
Qeshi plaku e shumë u gjëzue,

1) Vend në Spaç (Mirditë), ku filluan punimet për ngritjen e minierës.

2) Bënte vezë.

- 25 me gjuhë t'vet i ka urue:
 — Moj Parti, t'paça sa malet,
 njiqind vjet nji tash me rrnue! —
 Filloi plaku përsëri!
- 30 — Ti, mor djalë, je shum'i ri,
 punët e vjetra mirë s'i di;
 se, gjithmonë, se ka qenëjeta,
 shumë pat vuejtun kjo Mirdita.
 Asnji gja n'ket vend nuk ndijshe,
 as za puntori, as sirenë fabrike,
 veç ndonji za qenit e ndonji kmonë kishe.
 ose priftin me predikue,
 bashkë me Gjonin (1) me ngatrrue,
 shpi më shpi e fis më fis.
 Tash na shndrit ylli i lirisë.

1) Gjon Marka Gjoni, kapidan i Mirditës, figurë e urryer
 e bajraktarizmit.

SELMAN CARA NJI DJALË I RI

N'Kurbnesh (1), n'male t'Selitës, (2)
 ku punojnë djemtë Mirditës,
 si gjithë populli n'Shipni,
 Selman Cara (3), nji djalë i ri,
 5 i vendosun për Parti,
 për Partinë i betue,
 vendit faqen me ja ndrrue,
 n'vend Partisë fjalën me ja çue,
 dit'e nat' ai ka punue.
 10 Nji e martë ka qillue,
 lajm'i zi na asht diftue;
 na u diftue nji lajm i zi:
 u vra Selmani, nji djalë i ri,
 në front t'punës, në galeri!
 15 — Të kisha gojë me bisedue,
 në Kurbnesh fjalën me çue,
 mos t'mërziten hiç për mue,
 ma fort planin me e tejkalue;
 ma fort planin ta tejkaloni,
 20 se anmiqtë kshtu i qorroni,
 vendin tonë do ta ndërttoni.
 Me marak nuk jam tue shkue,
 se Shqipninë e la ndërtue,
 me fabrika tue punue,

1) Qendër industriale në Mirditë, ku ndodhen miniera dhe fabrika e pasurimit të bakrit.

2) Krahinë e rrethit të Rrëshenit.

3) Komunist nga Zajsi i Selitës, minator në minierën e bakrit të Kurbneshit; u vra në janar 1960 duke punuar në galeri.

25 kombinate tue ndërtue,
n'socializëm popullin me e çue,
mos me ndejtë ma si dikur,
pa hapë shkollë, pa pasë kulturë.
Unë për vete s'kam mërzi,
30 ja baj gati brezit t'ri,
me jetue n'demokraci.
Me i çue fjalë nanës Parti:
T'rrosh sa malet ti n'Shipni,
me Enverin që na prin!

SA ME VRULL PUNON RINIA

Sa e bukur Shqipëria!
 Rroft' Enveri dhe Partia,
 që ngritën koperativa!
 Sa me vrull punon rinia;
 sa me vrull e nëpër ara,
 e bëjnë punën me gara.
5

PRIN BRIGADA E RINISË

Në koperativën tonë,
bereqeti det,
plot e plot u mbush hambari,
fshatarit sivjet.

- 5 Punojm' pa u lodhur fare,
përtej n'arë;
prin brigata e rinisë
dhe flamurin mban.
Nat'e ditë do të punojmë,
10 o për ditë punojmë;
zotimet që kemi marrë,
do t'i tejkalojmë.

KËSHTU BASHKË TË PUNOJMË

- Ku po shkoni kaq serbes,
thëllëzat e malit-o?
- Poshtë në fushat me vesë,
birbilat e malit-o!
- 5 — Hajdeni dhe ju me ne,
thëllëzat e malit-o!
- Ne do të shkojmë në arë,
Birbilat e malit-o!
- 10 — Ju ftojmë dhe ju në garë,
thëllëzat e malit-o!
- Kështu bashkë le të punojmë,
birbil'e thëllëza tok,
Shqipërinë ta lulëzojmë,
me dorën tonë të fortë!

60

MOJ RINI MËSONI MSONI

Porsa u ngrit kjo qeveri,
hapi drítë pér popullsi;
gjithkund ngriti shkolla t'reja,
shkrim e kndim me msue rinia.
5 Prej pushtetit popullor
ditë të bukra ne po gzojmë,
nxansit shkojnë në shkollë të re
me dëshirë e plot hare.
Msoni, msoni, moj rini,
pér lulzim të kësaj Shqipni;
moj rini, mësoni, msoni
gjithmonë para të marshoni!
10

NDREC NDUE GJOKA KISH QENË DRANGUE

Kërcet pushka, gjëmon tokë,
 u vra trimi Ndrec Ndue Gjoka! (1)
 Fort po qakan, tha, këto zana!
 — Ti, mori zanë, çka po thue?
 5 Ndrec Ndue Gjoka kish qenë drangue,
 shkollën normale kish mbarue;
 shkollën normale me Parti,
 me ba lufte për këtë Shqipni.
 Kur Shqipnia u çlirue,
 10 Ndrec Ndue Gjoka kish mendue
 këtë Mirditën me e ndryshue
 e me e ba si s'ka qënë kurrë,
 me arsim e me kulturë.
 Ke Enver Hoxha kishte shkue,
 15 Enver Hoxhës i ka kërkue
 pesdhjetë shkolla n'Mirditë me i ndërtue...
 Enver Hoxha asht que n'kambë,
 Ndrec Ndue Gjokës i ka thanë:
 — Të lumtë goja, mirë je mendue,
 20 se kshtu Partia ty t'ka mësue.—
 Ndrec Ndue Gjoka e Bardhok Biba, (2)
 nji ksi djemsh po ka Mirdita!...

1) Mësues i popullit, nga Bisaka e Fanit të Mirditës; pas çlirimt shef arësimi në këtë krahanë; u vra më 1946 nga kriminelët e bandave të Gjon Marka Gjonit.

2) Hero i popullit, sekretar i parë i Komitetit të Partisë të rrëthit të Mirditës, deputet i Kuvendit Popullor; u vra pabesish nga bandat tradhëtarë më 7 gusht 1949.

DO T'I MBROJMË KËTO KUFI

Urdhëri Athinë (1) dolli
 dhe u hap nëpër Greqi:
 — Zerva (2) pregatit ushtrinë
 të sulmojë Shqipëri;
 5 kërkon Korç' e Gjirokastër,
 të ngrëjë flamur'e tij. —
 Po këtu nuk është Zogu
 të ngarkohet me flori;
 komandant ësht' Enver Hoxha,
 10 i dalë nga populli.
 Po ti, po të duash eja,
 se neve jemi gati,
 të provosh armëtë tonë,
 djemt' që ka populli.
 15 Tunde, Enver Hoxha, tunde,
 se në këmbë ke ushtri,
 se neve jemi betuar:
 Do t'i mbrojmë këto kufi!

1) Në Athinë.

2) Një nga krerët e reaksionit grek, që pregatiti dhe kreuo provokacionin e armatosur në kufijtë tanë më 2 gusht 1949.

NJI PLLAMBË VEND MOS ME LËSHUE

Me dy gusht dyzet e nandë,
 n'kufi t'Grekut ka plasë nji gjamë,
 tanë ushtria janë çue n'kambë;
 janë çue n'kambë e janë hazrue,
 5 nji pllambë vend mos me lëshue!
 Këta zervista faqesi,
 sa lakmi kanë n'këtë Shipni,
 por kanë hasë n'sokola t'ri!
 Kur ushtritë luftën kanë zanë,
 10 dridhet toka në çdo anë;
 mitralozi zen tue vluе,
 predha, topi tue ushtue,
 thue se deti ka gjimue!
 Xhemal Tafa (1) n'ballë t'ushtrisë,
 15 me shokë t'vet luftën ka nisë:
 — Ndalni, grekë, he dalshi fare,
 nuk shkelet toka shqiptare!
 Se rrit djem trima si zana,
 rrit fatosa pelivana,
 20 djem Kurbini, djem krutanë,
 me sokola djem shkodranë,
 djem Shqipnie nga çdo anë,
 hudhen n'zjarr mu si luanë! —
 Pushka kristë, plumbi s'mette,

1) Nga fshati Vinjollë i Krujës; ra në luftë për të mbrojtur kufijtë e atdheut nga monarko-fashistët grekë (gusht 1949).

25 vendi vend Xhemalin s'zente...
Mitralozin pak ka ndalë,
sa me puthë Danin (1) në ballë.
Duel llogores, nëpër shtek,
fytemfyt me u kapë me grekë.
30 Si sokol Xhema u lëshue,
jo tue hecë, po tue fluturue,
nji çetë grekë i vu përpara
si lop t'djerrme nëpër ara.
Pushk'e bumje ka marrë valë,
veç atëhere Xhema asht ndalë:
Nji copë bumje i ka ra,
s'ka fuqi me luftue ma!
Me nji shok, përbri plague,
nis Xhemali me bisedue:
40 — T'm'i thush nanës, mos qaj për mue,
kam dhanë jetën për liri;
për liri e për Shipni;
për Shipni, për kët tokë t'parëve,
si u ka hije gjithë shqiptarëve!

1) Dan Bajramin, shokun e tij të ngushtë.

FJALA E SHOKUT ENVER

Gjashtë shkurt gjashtëdhjet'e shtatë
 u hap lajmi si rrufe,
 fjala e shokut Enver
 një gëzim i madh pér ne; (1)
 5 ngriti popullin në këmbë
 të ndërtoj' jetën e re
 dhe rinia me aksione
 do t'u qepet maleve.
 Do të punojm' nat'e ditë,
 10 të të zbukurojm', Atdhe.
 Armiqtë le të pëlcasin,
 ata që s'na duan ne!
 Do ndërtojmë socializmin
 mu në majë të majave;
 15 fjala e shokut Enver
 një gëzim i madh pér ne.

1) Fjala historike që mbajti shoku Enver në mbledhjen e përbashkët të disa organizatave bazë të Partisë së qytetit të Tiranës (6 shkurt 1967).

ENVER HOXHA NA KA MSUE

Enver Hoxha trim i trimit,
 ty ta lumsha dritën e synit!
 Më gjashtë shkurt mbajte fjalimin,
 atë ditë çikat gjetën shpëtimin.
 5 Në djep baba më kish fejue
 me nji burrë që s'ish për mue.
 Maillkue qoftë fejesa në djep,
 m'u shitë çika si lopë në treg!
 — Më fal, o tatë, se e gjej vetë fatin.
 10 Enver Hoxha na ka msue
 të mos jetë çika kafshë për dru.
 S'mbeta ma e mbyllun në kullë,
 me shokë shkova në hekurudhë.
 Kurrë ma e bukur s'm'u duk vera,
 15 mora burrin që m'desht zemra.

SOT KA LINDE NJI DJELL I RI

Sot ka lindë nji djell i ri
 për ne vajzat në Shëmri!
 Rrofsh Parti, trime me fletë,
 që vuajtjet tona na i ke hekë!
 5 Zotim gjithë fshati ka marrë,
 zjarr me i dhanë zakonit të parë,
 dhe na gratë me pasë liri,
 mos me u shitun si bakti. (1)
 Me gëzim sot po këndojmë,
 10 n'kooperativë s'bashku punojmë,
 do të ngremë fshatin e ri;
 rrofsh përjetë, o nanë Parti!

1) Pas fjalimit historik që mbajti shoku Enver më 6 shkurt 1967, një valë iniciativash revolucionare shpërtheu në të katër anët e vendit për flakjen e zakoneve prapanike. Kënga e sipërme është ngritur për zotimet që u muarën me këtë rast në fshatin Shëmri të rrëthit të Tiranës.

HAJDE BASHKË TË VALLZOJMË

Shokë, do t'ju them dy fjalë,
s'kishte ndodhur më parë,
të këndoymë në festival,
djem'e vajza të gjith' bashkë;
5 t'i këndoymë punës sonë,
punës sonë ndërtimtare;
t'i këndoym' Partisë së dashur,
mëmës sonë legjendare.
Hajde, bashkë të këndoymë,
hajde, bashkë të vallzojmë!
10 Pa shikoni Shqipërinë,
ndrit si yll dhe vetëtin!

I FLAKU PËRTEJ RINIA

Do këndoja, do dredh shaminë
 për Enverin, për Partinë,
 për të mirat që na vinë;
 Jet'e bukur në krahinë,
 5 si në gjithë Shqipërinë,
 po lulëzon fshati ynë.
 Dhe zakonet e këqia,
 që na kishte lënë Turqia,
 i flaku përtej rinia.

RINIA U NGRIT NË KËMBË

O malet e Shqipërisë,
mbushurë me trëndelinë
dhe bilbili kur ja thotë:
«Ta kemi për jet' Partinë!»
5 Ti moj feja dredharake,
ishe bër' si ferr' n'livadhe;
ti punoje për të huaj,
nuk e donje Shqipërinë;
rinia u ngrit në këmbë,
10 në themel t'vuri qysqinë!

SI GJITHË RINIA

Do të shkoj, moj nënë,
 dhe un'vullnetare,
 n'Elbasan filloi
 hekurudh'e madhe. (1)
 5 Një aksion të madh
 na besoi Partia,
 ndaj dhe un' do vete
 si gjithë rinia.
 Oh, sa jam e lumtur,
 10 sa më gëzon shpirti,
 shih sa lart atdheun
 Partia e ngriti!
 Ndaj, moj nën'e dashur,
 po shkoj vullnetare
 15 edhe un' me shoqet
 revolucionare.

1) Hekurudha Elbasan-Prenjas, aksion që ju besua Rinisë.

INISIATIVA JONË

Inisiativa jonë (1)
 kudo po jehon:
 «T'njohim historinë
 t'Partisë sonë,
 5 që çlirroi vendin,
 na solli lirinë,
 një baçe me lule
 bëri Shqipërinë».
 Pesëvjeçarët tanë
 10 ne po tejkalojmë,
 krenarë në botë
 përpara marshojmë.
 Të na rrojë Partia
 dhe shoku Enver,
 15 bënë Shqipërinë
 lule në pranverë!

1) Inisiativa e organizatës së BRPSH të fshatit Rremas (Lushnje) për studimin e historisë së PPSH dhe të veprave të shokut Enver.

I NDRIÇOI DRITA E MARKSIZMIT

Rrofsh për jetë, Parti madhështore,
që ke rritë klasën pungore,
me ide t'Marksit e edukove
si dje n'luftën çlirimtare

5 dhe sot n'punën ndërtimitare!

Na i jep tonin gjithë jetës t'vendit,
t'vazhdojmë rrugën e Ademit.

Në det t'hapët na i erdh deka
komunistit Adem Reka.

10 Akti i tij e frymëzoi

Pjetër Lleshin (1) që e pasoi,
n'linje t'Fanit, PE TE TE, (2)
armatosë me ket ide,

ka dhanë jetën, kreu detyrën,
gjallë as vdekë s'e nxiu ftyrën.

15 Koha nxjerr heroj pada,
Muhamet dhe Myrteza; (3)

Hrushovianët, kur banë bllokadën,
kta çanë tokën, nxorrën naftën.

1) Pjetër Llesh Doda, fillrojtës i linjës Kukës-Fan, që ra
në krye të detyrës më 30 dhjetor 1966, si punëtor revolucionar me
ndërgjegje të lartë e patriotike.

2) Shkronjat e para të fjalëve «Post-Telegraf-Telefon».

3) Muhamet Shehu, inxhinier komunist nga Bicaj i Ku-
kësit dhe Myrteza Kepi, teknik i ri nga Preza e Tiranës, ranë
në krye të detyrës si bij të popullit e të Partisë, më 15 shkurt
1967 në Linas; Heronj të punës socialiste.

- 20 Muhameti, djalë azgan, (1)
tremdhjetë vjeç duel partizan;
Myrtezai, nji shok rinet,
trupi i tij me gjak Partiet;
25 për ndërtimin e socializmit,
kanë krye akte t'heroizmit,
i ndriçoi drita e marksizmit.

1) trim, guximtar.

MYRTEZAI DJAL'I RI

Myrtezai (1), djal'i ri,
 punët kish nisë në gjeollogji,
 porse zjarri e stuhia,
 e ndanë Myrtën nga rinia.

5 T'kishte kalitë, Mvrtë, Partia,
 djalë besnik e guximtar,
 «lavdi ty», të thotë rinia,
 «je për ne shembull krenar».
 N'krye t'detyrës, tue punue,
 10 tubacionet me shpëtue,
 re si trim n'ballë t'furtunës,
 lavdi ty, hero i punës!
 Kur familja ka ndigjue.
 15 që je nda n'lule t'rinishë,
 tha se «ti na ke nderue,
 bir i jonë, trim i Partisë».

1) Myrteza Kepi (shih shënimin përkatës në këngën më lart).

TI RE NJË MIJRA U NGRENË

Ti u linde n'ato male,
 n'ato gërxhe, n'ato rrëza
 dhe u rrite dalngadalë
 bashk' me shqipe e thëllëza;
 5 ti u linde n'atë derë,
 ku kish rrjedhur gjaku lumë,
 që lirinë edhe ndërë
 çmonte nga çdo gjë më shumë.
 Shkurt' e vogël e Dukagjinit, (1)
 10 luftëtare e së resë,
 e aksionit, e guximit,
 re si trime mes trasesë;
 ti re një, mijra u ngrenë!

1) Shkurte Pal Vata nga Pecaj i Dukagjinit, e re revolucionare, që ra në nëndor 1967 në hekurudhën Rrogozhinë — Fier ku kish shkuar vullnetare. Me vendim të posaçëm të KQ të PPSH u pranua, në radhët e Partisë pas vdekjes (Shkurta ishte 15 vjeç).

N'PRAG T'FESTAVE TË NANDORIT

N'prag t'festave të nandorit
e dha jetën bir'i puntorit,
mësues i ri, bir kosovari,
le e rritë sokol shqiptari.

5 Shkoi në zonat e Malsisë
me çue dritën e Partisë... (1)
Baba i msuesit, burrë dai,
s'po i dobsohet zemra e tij;
muer nji letër e e ka shkrue,

10 Enver Hoxhës ja ka çue;
— Asht e randë vdekja e djalit,
të betohem me syt'e ballit,
po njiqind jetë ai të kishte,
për Partinë do t'i jipte....

15 — Biri juej, heroi i rinisë,
i Kosovës dhe i gjithë Shqipnisë,
e dha jetën n'ball t'furtunës
për idenë e Partisë Punës!

20 Këtë trim s'e harron Partia,
as rinia, as ushtria,
shpreh mirnlohjen gjithë Shqipnia...

1) Heroi i punës socialiste Ismet Sali Bruçaj, që ra në pragun e festave të Nëndorit 1968, kur po shkonte në katundin Lilaj të Malsisë së Shkodrës për të kremtuar festat së bashku me nxënësit e tij.

BIJ TË TILLË RRIT PARTIA

Data një, muaj dymbëdhjetë,
 o Agron! (1)
 në kufi ti fale jetën.
 Tyja shokët seç të muarën,
 5 me kurora të përcuallën.
 Ti, Agron, të rrish i qetë,
 në kufi ti nuk le shtek;
 se familja kuvëndoi,
 vëllan' tënd seç e dërgoi.
 10 Bij të tillë rrit Partia,
 prandaj ësht'e fort' Shqipria.

1) Kufitari trim Agron Elezi, që ra në krye të detyrës. Për zëvendësimin e tij shkoi i vëllai.

FUAT ÇELA SKRAPARLLI

Rrofsh për jet', o nën' Parti,
 për ç'mendon e punon ti,
 zgjove këtë njerëzi,
 u kalle një shpirt të ri!

5 Fuat Çela skraparlli, (1)
 një dialosh, një trim pa sy,
 me të bën bota çudi,
 për gjithë punët e tij:
 Me një vullnet të çelniktë,
 10 punon nat'e punon ditë,
 bën më lart nga treqind ditë;
 vullnetar shkon n'hekurudhë,
 katër herë ka dalë sulmues.

1) Fuat Çela nga Vërzhezha e Skraparit. Megjithëse i verber, bën lart nga 300 ditë pune si anëtar i kooperativës bujqësore të fshatit të vet. Ka shkuar edhe vullnetar në ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë — Fier. Shoku Enver punën e tij e ka vlerësuar si një shembull të lartë heroizmi.

FJALA E PARTISË ËSHTË VEPRA JONE

Fjala e Partisë është vepra jonë,
 sa malet të rrojë kjo Partia jonë!
 Punon gjithë populli, Partia drejton,
 akti Adem Rekës ne na frymëzon.

5 Në ball' të rrezikut gjithmon' të qëndrojmë,
 si bij të Partisë të gjith' të punojmë;
 shkollën e mbarojmë për kulturën tonë,
 diplomonë më kazmën neve e ndërrojmë;

10 do ngjitemi malit, bukën të prodhojmë,
 bujq të dalluar, fshatin ta lulëzojmë;
 të gjith' vullnetarë në aksion po shkojnë;
 stafetën do marrim, më tej do ta çojmë.
 Tronditen titistët për vrullin tonë,
 në mezin e dallgëve neve po marshojmë,

15 timonier Enveri neve na drejton.
 Me forcatë tona Atdheun ndërtojmë,
 gjithmon' të bashkuar fitoret i mbrojmë.
 Oshëtijnë malet për Partinë tonë,
 të dy sytë e ballit Partisë ja dhurojmë!


1) Përsëritet pas çdo vargu.

GATI ËSHTË RINIA

5

Na thërret Partia, gati është Rinia;
 gati, moj Parti, gati kur do ti! (1)
 Malet do t'i bëjmë si fushat pjellore,
 me kazma lopata si Shkurte Pal Vata;
 se kemi Partinë dhe shokun Enver,
 gaz e lumturi do kemi përherë.

1) Përsëritet pas çdo vargu.



BURIMET E LËNDËS

- Këngë popullore legjendare*, T. 1955: nr. 1, 25.
- Këngë popullore historike*, T. 1956: 3-20, 33-35, 38, 44, 53.
- Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*, v. I, T. 1961: 2.
- Këngë popullore lirike*, T. 1955: 21-22, 24, 27-32.
- Këngë popullore dashurie*, T. 1965: 26.
- Për Partinë shqipe mali*, T. 1961: 36, 37, 41-43, 45-52, 54-56, 60, 61, 62, 63.
- Këngë popullore të Luftës nacional-çlirimtare dhe të rindërtimit*, T. 1951: 39.
- Këngë dhe tregime popullore për gruan*, T. 1968: 59.
- Na ndrit ylli i Partisë*, T. 1968: 72, 74.
- Arkivi i Institututit të Folklorit: 64, 66, 67, 68-71, 73, 75-79.

PËRMBAJTJA

Faqe

Parathënie	3
------------------	---

I. KËNGË LEGJENDARE

1. Gjergj Elez Alia	7
---------------------------	---

II. KËNGË HISTORIKE TRADICIONALE

2. Rina dhe Radhavani	13
3. Me se erdhe, ku i ke shokët	15
4. Kurvelesh krye të ngrini	16
5. Me palla lëftoni sheshit	17
6. Ç'janë ata që shkojnë zallit	18
7. Djemuria si furtunë	19
8. Do ta mbush rrapiin të vrarë	20
9. Ndesh pér burra n'do djem të ri	21
10. Bje' haldupit të pabesë	23
11. Miro Tërbaçja	24
12. Haxhi Gashi nji trim me fletë	25
13. Të tanë zaptitë qesh tue i la n'gjak	26
14. Halil Gashi nji djalë i ri	27
15. Luftë po ban nji djal' i ri	28
16. Kurrë s'po shkelet kjo Shqipni	29
17. Lëftojnë e s'u tundet këmba	31
18. Avni vatanë e nderove	32
19. Rrofshin djemptë tanë shkollarë	33
20. Djal i popullit Halim	34

III. KËNGË LIRIKE TRADICIONALE

21. Vashëza mandileverdhë	37
22. Dolli sorkadhja nga pylli	38
23. A je brymë moj a je borë	39
24. Mori drandofillja e bardhë	40
25. Unë Tanushen vet e kam pa	41

26. Dashunia nuk harrohet	42
27. Me grosh mixha më ka shitë	43
28. M'ka dhanë baba nji burrë të keq	44
29. U nis plaku e djali bashkë	45
30. Nuk asht plaka për sokola	46
31. Djem u hëngri ksenitia	47
32. Qani o nëna na qani	48

IV. KËNGË PËR L.N.ÇL.

33. Merrni armët dhe i bini	51
34. Me gjak po t'i heq rinia	52
35. Djemtë tanë partizanë	53
36. Dolli Enver Hoxha vetë	54
37. E tunde Parti e tunde	55
38. Gjëmon klithm' e djalërisë	56
39. Po lëshohen djem e vajza të bashkuar	57
40. T'u këndojmë trimave	58
41. Jam një vajzë shqipëtare	59
42. Kudo që po shkon ti çliron vatanë	60
43. S'ke parë djemt e Shqipërisë	61
44. Gjakun mos ma falni	62
45. Misto Mames	64
46. Dëshmorëve të Vigut	65

V. KËNGË TË PERIUDHËS SË NDËRTIMIT SOCIALIST

47. O Partia heroike	69
48. N'tkatër anët na pyet bota	70
49. Puno moj rini me flakë	71
50. Shoqe na thérret Partia	72
51. Ti moj vajza shqipëtare	73
52. Për Partinë shqipe mali	74
53. Pararojë kjo rini	75
54. Posi zjarr e si shkëndia	76
55. Në kambë asht ngritë gjithë rinia	77
56. Selman Cara nji djali ri	79
57. Sa me vrull punon rinia	81
58. Prin brigata e rinisë	82
59. Kështu bashkë të punojmë	83
60. Moj rini mësoni mësoni	84
61. Ndrec Ndue Gjoka kish qenë drangue	85
62. Do t'i mbrojmë këto kufi	86
63. Nji pllambë vend mos me lëshue	87
64. Fjala e shokut Enver	89

65. Enver Hoxha na ka msue	90
66. Sot ka lindë një diell i ri	91
67. Hajde bashkë të vallzojmë	92
68. I flaku përtej rinia	93
69. Rinia u ngrit në këmbë	94
70. Si gjithë rinia	95
71. Inisiativa jonë	96
72. I ndriçoi drita e marksizmit	97
73. Myrtezai djalë i ri	99
74. Ti re një, mijra u ngrenë	100
75. N'prag të festave t'nëndorit	101
76. Bij të tillë rrit Partia	102
77. Fuat Çela skraparli	103
78. Fjala e Partisë është vepra jonë	104
79. Gati është rinia	105
— Burimet e lëndës	107